



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2019:075225

Datë: 29.03.2019

Numri i dokumentit: 00262619

**P.nr.96/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit Y.A. nga fshati D., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale: lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.1454/2017, të datës 24.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik, **me datën 29.03.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të dëmtuarit B.P. si dhe përfaqësuesit të tij autorizuar av.Y. B. nga Gjakova, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të av.R. H. nga P., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli dhe e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**Y.A.**, nga i ati J., e ëma M., e gjinisë A., data e lindjes ..., në Gjakovë, tani me vendbanim në fshatin D., Komuna e Gj., i pa martuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Me datë 23.09.2017 rreth orës 22:40 minuta mori në rrugën “...” në Gjakovë, përkatësisht tek kafiteria “T.B.”, tjetrit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, ashtu që ditën kritike pas një fjalosje të mëparshme, për shkak të një shiqimi të shtrembër gjersa të pandehurit gjindeshin në lokal, ashtu që siç ishte edhe i dëmtuari B.P., dhe me të shiquar në sy mes vete dalin jashtë, me ç’rast fillojnë të fjalosen mes vete ku edhe e godasin të dëmtuarin B. me grushta në kokë dhe trup duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore Dr. F. B.e datës 24.10.2017.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe nenit 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

**ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

I dëmtuari B.L.) P. nga Gj., me banim në rrugën “...”, p.n, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

**Detyrohet** i akuzuari që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzet) Euro, shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe në emër të kompensimit për viktimat e kimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përbarimit.

## A r s y e t i m

### I. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1454/2017, të datës 24.01.2018, kundër të akuzuarve Y. A. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe kundër të akuzuarit A. H. nga Gj., për shkak të veprave penale: lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, gjatë shqyrtimit fillestar të datës 31.01.2019 ka marr aktvendimin P.nr.60/18, të datës 31.01.2019, me të cilin ka aprovuar propozimin e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj dhe ka veçuar procedurën penale kundër të akuzuarit Y.A. nga fshati D., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur që procedura penale ndaj tij do të zhvillohet ndaras dhe lënda ndaj tij do të procedohet në këtë gjykatë sipas numrit të ri të regjistrimit penal të departamentit të përgjithshëm të kësaj gjykate, për shkak se nuk ka mundur të sigurohet prezenca e tij në procedurë për shkak se nga Stacioni Policor në Gjakovë me anë të raportit me numër Ref.04/1-08-Gj-S-38/19 të datës 31.01.2019 para seancës së shqyrtimit fillestar gjykata është njoftuar se i akuzuari Y. A. nuk gjendet në Kosovë, i njëjti gjendet në G. dhe këtë e kishte konfirmuar edhe babai i tij J. A..

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës, kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënohej sipas ligjit.

I akuzuari Y. A., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe shton se jam penduar për këtë veprim dhe i kërkoj falje palës së dëmtuar për rastin që ka ndodhur prandaj premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar B.P. av.Y.B., duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë, në cilësinë e të autorizuar të dëmtuarit duke pasur parasysh se i dëmtuari dhe i akuzuari janë pajtuar nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike kërkojmë që gjykata të na udhëzojë në kontest të rregullt juridiko-civil.

I dëmtuari B. P. duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe si i dëmtuar deklaron se në tërësi pajtohet me theksimet e përfaqësuesi të tij të autorizuar av. Y. B., por vetëm desha të shtoj se me të akuzuarin jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe.

Mbrojtësi i të akuzuarit Y.A.i av. R. H. duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: jemi pajtuar me të akuzuarin që të pranohet fajësia duke marr parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë qenë të krijuara me rastin e kryerjes së veprës penale të lëndimit të lehtë trupor prandaj nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë meqenëse i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnetin e tij të plotë.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.R. H., pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se i akuzuari Y. A., me dashje e ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën dhe vendin dhe mënyrën e përshtuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 188 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “*Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor i cili rezulton me: Nën paragrafi 1.4 të këtij neni ka përcaktuar: dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit*”. Ndërsa, në nenin 31 është parashikuar bashkëkryerja si lloj i bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale: e cila konsiderohet se ekziston “*Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.*”

#### 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin Y.A. e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së prandaj edhe për këtë ka vendosur që ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij duke i kërkuar fjale publikisht palës së dëmtuar dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se me palën e dëmtuar janë pajtuar si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së dhe se ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për

programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**

**- Departamenti i përgjithshëm -**

**P.nr.96/19, me datë 29.03.2019**

**Procesmbajtësja,  
Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.